

**VENDIM**  
**Nr. 945, datë 28.12.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.408, DATË 8.5.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DËMSPËRBLIMIN PËR KAFSHËT E ELIMINUARA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 49, të ligjit nr.10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 408, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë vendimin, emërtimi “drejtoria rajonale e bujqësisë në qark (DRB)” zëvendësohet me emërtimin “drejtoria e bujqësisë (DB)”;

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Pronarët e kafshëve, të cilat kanë ngordhur si pasojë e prekjes nga sëmundja e Dermatozës Nodulare të Gjedhit, dëmshpërblehen fizikisht me kafshë, sipas pikës 13, të këtij vendimi”.

3. Në pikën 2, fjalja e parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Janë subjekt dëmshpërblimi sipas pikave 1 dhe 1.1, të këtij vendimi, vetëm pronarët e kafshëve, të cilat:”.

4. Në pikën 4, fjalët “...një përfaqësues i shërbimit veterinar të njësisë së qeverisjes vendore...” zëvendësohen me “...një përfaqësues i qeverisjes vendore...”.

5. Në pikën 7, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d”, si më poshtë vijon:

“d) menjëherë, pas konfirmimit zyrtar, në rastin e sëmundjes së Dermatozës Nodulare të Gjedhit.”.

6. Në fund të pikës 9 shtohet fjalja, me këtë përmbajtje:

“Ky komision kryen edhe vlerësimin e dokumentacionit në rastin e dëmshpërblimit fizikisht me kafshë.”.

7. Në pikën 11, në fund të fjalisë së parë shtohen fjalët “...ose procesverbalin e dëmshpërblimit fizik në kafshë...”.

8. Në fund të pikës 13 shtohet fjalja, me këtë përmbajtje:

“Dëmshpërblimi fizik me kafshë do të bëhet në përputhje me procedurat e prokurimit public, sipas legjislacionit në fuqi.”.

9. Pika 14 riformulohet, si më poshtë vijon:

“14. Titullari i DB-së nxjerr aktin për dëmshpërblimin e pronarit të kafshës, i cili duhet të zbatohet nga DB-ja brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dalja e aktit të dëmshpërblimit, me përjashtim të rastit kur dëmshpërblimi bëhet fizik me kafshë, për të cilat ndiqen procedurat e prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi.”.

10. Pika 17 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“17. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe njësitë e qeverisjes vendore.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**